



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit / Kancelarija Glavnog Drzavnog  
Tuzioca / Office of the Chief State Prosecutor

AD.nr. 01/2025

Dt. 19 Mars 2025

Prishtinë

Në kuptim të nenit 9 par.1, nënpar.1.4 lidhur me par. 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve(Ligji.nr.06/L-057), në lidhje me ankesën e karakterit disiplinor të palës: [REDACTED] të dt.27.02.2025,në raport me [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED] pas shqyrtimit dhe analizimit të pretendimeve të palës ankuese në fjalë, unë si autoritet kompetent, nxjerr si në vijim këtë:

### V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa e palës: [REDACTED] 02.2025, në raport me [REDACTED] [REDACTED] [REDACTED] [REDACTED] [REDACTED] lidhur me pretendimet që i njëjti të mos ketë qenë në nivelin e trajtimit objektiv e profesional të çështjeve disiplinore, sipas ankesave të palës në fjalë, në raport me prokurorët e shtetit në të njëjtën prokurori: [REDACTED] dhe [REDACTED] mw rastet e nxjerrjes sw vendimeve disiplinore refuzuese: [REDACTED] [REDACTED] të [REDACTED], të cilat ishin të ndërlidhura me çështjen penale: [REDACTED], ngase pretendimet e tilla ankimore nuk kanë të bëjnë me ndonjë shkelje të mundshme disiplinore nga ana e subjektit në fjalë.

### A r s y e t i m

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit-U.D. Kryeprokurori i Shtetit, më dt.04 Mars 2025, nga Prokuroria e Apelit [REDAKTUAR], ka pranuar një akt përcjellës me shenjë e referencës: [REDAKTUAR] të dt.03.03.2025, të cilës ia kishte bashkangjitur ankesën me dokumentacion shtesë të palës ankuese: [REDAKTUAR] të dt.27.02.2025. Kjo palë ankuese përmes të njëjtës ankesë kishte ngritur pretendimet e veta në raport me [REDAKTUAR], pwr mos trajtimim objektiv e profesional të çështjeve disiplinore sipas ankesave të palës në fjalë, në raport me prokurorët e shtetit në të njëjtën prokurori: [REDAKTUAR], mw rastet e nxjerrjes sw vendimeve disiplinore refuzuese: [REDAKTUAR] të dt.06.02.2025 dhe [REDAKTUAR] të dt.11.03.2025, ankesa këto të ndërlidhura me çështjen penale: [REDAKTUAR], sa i përket mos lëshimit të urdhërimit për heqjen e drynit nga lokali i tij, i cili dry, që nga dt.13.01.2025, me veprime kriminale ishte vendosur nga të pandehurit [REDAKTUAR], të cilët edhe janë akuzuar sipas aktakuzës [REDAKTUAR] të dt.31.01.2025 për 3(tri)vepra penale të kryera në bashkëkryerje sipas neneve:197, 321 e 410 të KPRK-së.

#### **Kronologjia e fakteve të rastit:**

-Në kontekst të shqyrtimit dhe analizimit të pretendimeve ankimore të parashtruara në ankesën e sipër cekur të palës ankuese në fjalë, Unë si autoritet kompetent, në kuptim të dispozitës së nenit 9 par.1 nënpar.1.4 dhe par.6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (Ligji.nr.06/L-057), kam ndërmarrë veprimet e parashikuara ligjore në raport me [REDAKTUAR], ashtu që sipas shkresës zyrtare: [REDAKTUAR] të dt.12 Mars 2025, kam kërkuar raport të detajuar me shkrim rreth ecuresë së trajtimit të çështjeve disiplinore në raport me prokurorët e shtetit: [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], për çka subjekti i kësaj çështjeje disiplinore kishte nxjerr 2(dy) vendimet refuzuese të ankesave disiplinore të kësaj pale me shenjat: [REDAKTUAR] të dt.06.02.2025 dhe [REDAKTUAR] të dt.11.03.2025.

-Në ndërkohë, më dt.13 Mars 2025, nga [REDAKTUAR], lidhur me çështjen e kërkuar si më lart kam pranuar raportin - njoftimin e detajuar me shkrim me nr.reference: A.nr.17/2025 të dt.13.03.2025, rreth ecuresë së trajtimit të atyre dy çështjeve disiplinore të sipërcekura.



-Pas analizimit dhe shqyrtimit në mënyrë të gjithanshme të gjitha rethanave faktike të kësaj çështjeje disiplinore e në korrelacion me pretendimet e palës ankuese [REDACTED] kam arritur në përfundimet si në vijim:

-Nga përmbajtja e raportit - njoftimit të sipër cekur me shkrim të [REDACTED] rreth ecurisë së trajtimit të çështjeje disiplinore të sipërcekura dhe kërkesave të palës ankuese në fjalë rezulton se:

“Pala ankuese [REDACTED] më dt.13.01.2025, pranë [REDACTED] në cilësinë e palës së dëmtuar kishte denoncuar rastin e hyrjes së kundërligjshme në lokal si dhe heqjes së kundërligjshme të inventarit dhe dokumentacionit të firmës-biznesit të tij [REDACTED] nga ana e të dyshuarve: [REDACTED] dhe djali i tij [REDACTED]. Të njëjtit tërë këtë inventar dhe dokumentacion e kishin nxjerrë jashtë lokalit ku njëherit edhe ia kishin vënë dryrin lokalit në fjalë i cili lokal ishte kontestues në mes të dëmtuarit [REDACTED] dhe vëllait të tij tani të akuzuarit [REDACTED].

-Lidhur me këtë çështje denoncuese [REDACTED] kishte njoftuar prokuroren kujdestare: [REDACTED] e cila pas marrjes së informacioneve më të detajuara kishte udhëzuar hetuesit policor që në rastin konkret të iniciohet rasti paraprak penal në drejtim të veprave penale: Cenimi i paprekshmërisë së banesave dhe objekteve sipas nenit 197 të KPK-së dhe Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë sipas nenit 321 të KPK-së.

[REDACTED] pas ndërmarrjes së veprimeve të nevojshme ligjore më dt.17 Janar 2025 në [REDACTED] kishte dorëzuar kallëzimin penal [REDACTED] kundër të dyshuarve: [REDACTED] e [REDACTED] në drejtim të veprave penale: Cenimi i paprekshmërisë së banesave dhe objekteve sipas nenit 197 të KPK-së dhe Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë sipas nenit 321 të KPK-së, i cili rast penal sipas sistemit të SMIL-it i ishte ndarë në punë prokurorit të shtetit [REDACTED] dhe çështja ishte protokolluar me shenjen e regjistrit: [REDACTED]. I njëjti prokuror i shtetit në afat optimal e kishte trajtuar të njëjtin kallëzim penal ku më dt.31 Janar 2025, pas vlerësimit të drejtë të gjitha provave relevante kishte ngritur aktakuzën e drejtpërdrejtë kundër dy të dyshuarve të përfshirë në atë kallëzim penal, në drejtim të veprave penale: Cenimi i paprekshmërisë së banesave dhe objekteve sipas nenit 197 të KPK-së, Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë sipas nenit 321 të KPK-së dhe Vetëgjyqësia sipas nenit 410 të KPK-së.

-Pala ankuese [REDACTED] [REDACTED] më dt.22 Janar 2025, te [REDACTED] i [REDACTED] [REDACTED] [REDACTED], kishte parashtruar ankesë disiplinore ndaj prokurores së shtetit [REDACTED] [REDACTED] me pretendimet se e njëjta nuk e kishte trajtuar rastin e tillë penal me profesionalizëm.

-Më dt.28 Janar 2025 pala ankuese [REDACTED] [REDACTED] ishte pritur në takim zyrtar nga [REDACTED] i [REDACTED] [REDACTED] [REDACTED] ku ishte njoftuar për ecurinë e procedurës penale rreth rastit konkret si dhe sa i përket procedurës për pengim të posedimit.

-Më dt.06 Shkurt 2025, [REDACTED] [REDACTED] [REDACTED] [REDACTED], pas shqyrtimit të hollësishëm të ankesës disiplinore të palës ankuese në fjalë ndaj prokurores së shtetit [REDACTED] [REDACTED], kishte nxjerr vendimin refuzues me shenjë: [REDACTED] të dt.06 Shkurt 2025, duke konsideruar se prokurorja e shtetit në fjalë në kuadër të kompetencave të saja ligjore, me rastin e trajtimit të rastit të sipërcekur penal, kishte vepruar me profesionalizëm, pavarësi, dhe paanshmëri.

-Pala ankuese [REDACTED] [REDACTED], gjithashtu më dt.27 Shkurt 2025 pranë [REDACTED] nw [REDACTED] kishte parashtruar ankesë të karakterit disiplinor edhe ndaj prokurorit të shtetit [REDACTED] [REDACTED], me pretendimet për mos trajtim adekuat ligjor të rastit penal [REDACTED], ku kjo palë kishte cilësinë e të dëmtuarit.

-Më dt.11 Mars 2025, [REDACTED] [REDACTED] [REDACTED] [REDACTED], pas analizimit dhe shqyrtimit të hollësishëm të ankesës së tillë disiplinore të palës ankuese në fjalë ndaj prokurorit të shtetit [REDACTED] [REDACTED], kishte nxjerr vendimin refuzues me shenjë: [REDACTED] të dt.11 Mars 2025, duke konsideruar se prokurori i shtetit në fjalë, në kuadër të kompetencave të tij ligjore me rastin e trajtimit të rastit të sipërcekur penal të ketë vepruar me profesionalizëm, pavarësi, dhe paanshmëri. Për më tej Prokurori i shtetit [REDACTED] [REDACTED], pas trajtimit adekuat ligjor - procedural të rastit të sipërcekur penal kishte ngritur aktakuzën [REDACTED] të dt.31 Janar 2025 kundër [REDACTED] [REDACTED] e [REDACTED] [REDACTED] në drejtim të veprave të sipërcekura penale.

Në raport me palën ankuese [REDACTED] [REDACTED], nga evidenca e [REDACTED] [REDACTED] është konstatuar se i njëjti të ketë qenë në disa situata i akuzuar nga kjo prokurori në lidhje me mosmarrëveshjet që i njëjti të ketë pasur në vazhdimësi me vëllezërit e tij me aftësi të kufizuara (shurdhmemec) [REDACTED] [REDACTED] e [REDACTED] [REDACTED] pikërisht për shkak të çështjes së pronësisë së të njëjtit lokal, ku pala ankuese kishte ushtruar biznesin e tij të



[REDACTED] Pra në 7 (shtatë) situata ishin ngritur aktakuza kundër tij për vepra të ndryshme penale si kanosje, lëndim i lehtë trupor, mospërfillje e gjykatës, asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë aktakuza këto me shenjat e regjistrat: [REDACTED] të dt.30.05.2014, [REDACTED] të dt. 19.12.2017, [REDACTED] të dt. 19.07.2018, [REDACTED] të dt.30.09.2019, [REDACTED] të dt.28.09.2020, [REDACTED] të dt.11.12.2024 dhe e fundit [REDACTED] e dt. 05 Mars 2025.

Prandaj, pretendimet e palës ankuese: [REDACTED] të parashtruara në ankesën e tij disiplinore në raport me [REDACTED] e [REDACTED], [REDACTED], se i njëjti të mos ketë qenë në nivelin e trajtimit objektiv e profesional të atyre çështjeve disiplinore, në raport me prokurorët e shtetit në të njëjtën prokurori: [REDACTED] e [REDACTED], për çka subjekti në fjalë kishte nxjerr vendimet refuzuese të ankesave të tilla disiplinore me shenjat: [REDACTED] të dt.06.Shkurt 2025 e [REDACTED] të dt.11 Mars 2025, lidhur me çështjet e sipërcekura, konsistojnë kryesisht në vlerësimin subjektiv të tij. Kjo për arsye se nga gjendja e fakteve të elaboruara si më lartë, rezulton qartë se subjekti i kësaj ankese: [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED], me asnjë nga veprimet e tija nuk kishte kryer ndonjë nga shkeljet e pretenduara të natyrës disiplinore apo profesionale, përkundrazi i njëjti subjekt iu kishte përmbajtur të gjitha kriteret të parashikuara ligjore, profesionale dhe etike në trajtimin e ankesës disiplinore po të kësaj pale ankuese.

-Për më tej [REDACTED] i prokurorisë përkatëse nuk ka autorizime ligjore që të ndikoj tek një prokuror i shtetit që e ka nën varësi lidhur me aspektet e të vendosurit në një lëndë të caktuar penale, rrethanë kjo e bazuar në nenin 21 par.1 nënpar.1.8 të Ligjit për Prokurorin e Shtetit nr.08/L-167,ku në mënyrë të qartë është parashikuar se “Kryeprokurori mund tu jap udhëzime me shkrim prokurorëve të një prokurorie që udhëheq me qëllim të zbatimit të ligjshmërisë, ngritjes së efikasitetit dhe zbatimit unik të praktikave dhe legjislacionit, mirëpo udhëzimet e tilla duhet të jenë të arsyetuara dhe nuk duhet të cenojnë pavarësinë funksionale dhe profesionale të prokurorëve”. Rrjedhimisht udhëzimet e tilla nënkuptohet se nuk duhet të përmbajnë referime për sa i përket kualifikimit të veprës penale, metodave të hetimit dhe mbledhjes së provave si dhe arsyetimit të hetimit dhe aktakuzës”.

Po ashtu, sipas nenit 8 par.1 nënpar.1.1 të Ligjit për Prokurorin e Shtetit nr.08/L-167, janë përcaktuar detyrat dhe kompetencat e prokurorëve të shtetit ku përfshihet se të njëjtit gjatë “ushtrimit të funksioneve prokuroriale

në mënyrë të pavarur, të drejtë, objektive dhe të paanshme të sigurohen që të gjithë personat trajtohen në mënyrë të barabartë para ligjit”.

Andaj, duke u bazuar në atë që u theksua më sipër, kam konsidëruar se pretendimet e palës ankuese: [REDACTED] nuk ndërlidhen me asnjë nga rrethanat e parashikuara ligjore, që paraqesin shkelje të natyrës disiplinore dhe për këtë arsye kjo çështje ankimore-disiplinore konsiderohet e mbyllur: A.A.

Besim Kelmendi

U.D. Kryeprokuror i Shtetit